



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kaçanik
Municipal Kaçanik-
-Kuvendi i Komunës-
01Nr. 16-1318 /2012
Kaçanik, 31.01.2012

Në bazë të nenit të Ligjit Nr. 43 03L-/040- Për Vetëqeverisjen Lokale, të neneve: 34.5 dhe 36 lidhur më nenet: 40, 41 dhe 42 të Statutit të Komunës, të nenit 15(c) lidhur me nenin 24 të Rregullorës për Punë të Kuvendit, Kuvendi i Komunës Kaçanik, më datë: 31.01.2012

V E N D I M
PËR APROVIMIN E PLANIT I PUNËS SË KUVENDIT TË KOMUNËS
KAÇANIK PËR VITIN 2012

I.

Me këtë Vendim, Aprovohet Plani i Punës së Kuvendit të Komunës Kaçanik, për vitin 2012.

II.

Kuvendi i Komunës Kaçanik, në vitin 2012, Planifikon t'i mbajë gjithsej, 10 Mbledhje të Rregullta.

III.

Mbledhjet e Rregullta të Kuvendit të Komunës, do të mbahen sipas këtij Plani të Punës:

PLANI I MBLEDHJEVE TË KUVENDIT

	Numri i mbledhjeve	Përiudha Kohore	Vendi i mbajtjes	Ora	Rendi i Punes	Kryesimi i mbledhjeve
1	2	3	4	5	6	7
01.	Mbledhja e I-rë	23-31.01.2012	Katin e III-të, në Sallën e Kuvendit	11:00	1.Procesverbali nga mbledhja e XI-të e rregullt e kuvendit, për vitin 2011; 2. Propozimi për Ndryshim Plotësimi i Vendimit për formimin e KPF-a; 3. Plani i Punës së Kuvendit të komunës për vitin 2012; 4. Raporti i Punës së Ekzekutivit të komunës për vitin 2011; 5. Plani i Veprimit për përmirësimin e shërbimit të shenjëzimit rrugor. 6. Propozim-Vendimi për bartjen e bilanceve të pashpenzuara nga të hyrat vetjake komunale të vitit 2010 dhe 2011, në vitin fiskal 2012.	Kryesuesi i kuvendit
02.	Mbledhja e II-të	22-29.02.2012	- “ -	11:00	1. Procesverbali nga mbledhja e I-rë e Rregullt e kuvendit të komunës, për vitin 2012; 2. Raporti i Punës së Komitetit për Politikë dhe Financa (KPF-a), për vitin 2011; 3. Raporti Vjetor Financiar, për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2011; 4. Propozim-Vendimi për Hartimin e Planeve rregulluese për Zonat Turistike.	-“-
03.	Mbledhja e III-të	26-30.03.2012	-“-	11:00	1. Procesverbali nga mbledhja e II-të e Rregullt e kuvendit të komunës; 2. Propozim-Rregullorja për pagesën e tarifave dhe ngarkesave administrative dhe shërbimeve të tjera komunale (ndryshimet dhe plotësimet);	-“-

					3. Propozim-Vendimi për caktimin e Zonave për dhënje në shfrytëzim të pronës komunale për rastet sociale dhe familjet e dëshmorëve; 4. Propozim-Vendimi për ndryshimin dhe emërimin e pronës së paluajtshme komunale.	
04.	Mbledhja e IV-të	23-30.04.2012	-“-	11:00	1. Procesverbali nga mbledhja e III-të e rregullt e kuvendit të komunës; 2. Raporti për realizimin e mjeteve buxhetore për periudhën : Janar-Mars, 2012. 3. Propozim-Rregullorja për dhënjën e banesave në shfrytëzim me qira.	-“-
05.	Mbledhja e V-të	24-31.05.2012	-“-	11:00	1. Procesverbali nga mbledhja e IV-të e rregullt e kuvendit të komunës; 2. Qarkorja e brendshme buxhetore nr. 01/2013; 3. Propozim-Vendimi për emërtimin dhe riemërtimin e rrugëve lokale në teritorin e komunës së Kaçanikut.	-“-
06.	Mbledhja e VI-të	25-29.06.2012	-“-	11:00	1. Procesverbali nga mbledhja e V-të e Rregullt e kuvendit të komunës; 2. Korniza Afatmesme e Shpenzimeve Komunale për periudhën afatmesme, 2013-2015; 3. Raporti i Auditorit të Pavarur (ZAGJ), për vitin 2011.	-“-
07.	Mbledhja e VII-të	23-31.07.2012	-“-	11:00	1. Procesverbali nga mbledhja e VI-të e rregullt e kuvendit të komunës; 2. Raporti për realizimin e mjeteve buxhetore, për periudhën, Janar-Qershor, 2012;	-“-

					3. Propozim-Vendimi dhe Pasqyrat financiare për Rishikimin Gjashtëmujorë të Buxhetit , për vitin,2012. 4. Qarkorja e brendshme buxhetore nr. 02/2013;	
08.	Mbledhja e VIII-të	24-28.09.2012	-“-	11:00	1. Procesverbali nga mbledhja e VII-të e rregullt e kuvendit të komunës; 2. Draft - Buxheti i Komunës për vitin 2013 dhe vlerësimet për periudhën e viteve, 2014-2015; 3. Propozim-Rregullorja për vendosjen e Tatimit në Pronë, në teritorin e komunës së Kaçanikut, për vitin 2013.	-“-
09.	Mbledhja e IX-të	24-31.10.2012	-“-	11:00	1.Procesverbali nga mbledhja e VIII-të e rregullt e kuvendit të komunës; 2.Propozim-Vendimi për rregullimet buxhetore nga ndarjet me Buxhetin e komunës për vitin 2012; 3.Informatë e Drejtorisë së Arsimit për përfundimin e vitit shkollor, 2011/2012.	-“-
10.	Mbledhja e X-të	26-30.11.2012	-“-	11:00	1.Procesverbali nga mbledhja e IX-të e rregullt e kuvendit të komunës; 2.Raporti i realizimit të mjeteve buxhetore, për periudhën, Janar-Shtator 2012; 3. Plani i Punës së Ekzekutivit të Komunës, për vitin 2013.	-“-

IV.

Kuvendi i Komunës Kaçanik, në muajin shtator do të mbajë dëgjim publik me qytetarë për çështjen e draft-buxhetit të komunës për vitin 2013 dhe projeksionet për vitet: 2014-2015, para se të aprovohet drafti i buxhetit në kuvend.

V.

Kuvendi i Komunës Kaçanik, gjat vitit 2012, mund të mbajë edhe mbledhje tjera të Rregullta më shumë se minimumi i paraparë me aktet në fuqi. Të gjitha mbledhjet e Rregullta do të mbahen vetëm ditëve të punës.

VI.

Materialet që i adresohen Kuvendit të Komunës, janë kryesisht çështje të propozuara nga ekzekutivi i komunës, e që kalojnë procedurën e shqyrtimit dhe aprovimit të KPF-a, dhe të njëjtat, me Rekomandim të KPF-a i kalojnë KK për shqyrtim dhe miratim apo në procedurë të mëtejme.

VII.

Të gjitha mbledhjet e Rregullta të KK do të jenë hapura për qytetarë dhe përfaqësuesë të mediave publike. Nëse ndonjë mbledhje e Rregullt apo pjesë e mbledhjes do të mbahet me dyer të mbyllura atëherë për këtë duhet të vendosë Kuvendi i Komunës. Nëse mbledhja mbahet me dyer të hapura, në mbledhjet mund të marrin pjesë qytetarët e komunës dhe përfaqësuesë të mediave në përputhje me kushtet dhe mundësitë fizike.

VIII.

Kuvendi i Komunës mund të mbajë edhe mbledhje tjera, varësisht prej nevojave që paraqiten.

IX.

Njoftimet për mbledhje të Kuvendit të Komunës bëhen publike. Materialet për Mbledhjet e Rregullta të Kuvendit të Komunës iu dorëzohen të gjithë anëtarëve të Kuvendit të Komunës 7 ditë para mbajtjes së mbledhjes. Njoftimet dhe Materiali i mbledhjes i dërgohet edhe Ministrisë së Pushtetit Lokal.

X.

Kuvendi i Komunës për gjat muajit gusht do të jetë në Pushim Vjetorë. Për fillimin dhe mbarimin e pushimit, anëtarët e kuvendit do të njoftohen paraprakisht. Për gjatë pushimit nuk planifikohet mbajtja e ndonjë mbledhje përveç nëse paraqitet ndonjë çështje eventuale, atëherë nuk përjashtohet mundësia të mbledhet Kuvendi i Komunës.

XI.

Plani i Mbledhjeve të Kuvendit, i përcaktuar si në pikën III. të këtij Vendimi, është orientues e nuk do të thotë se nuk pëson ndryshime.

XI.

Plani i Mbledhjeve të Kuvendit të Komunës për vitin 2012, ka fuqi veprimi nga data: 01.01.2012-31.12.2012.

KRYESUESI I KUVENDIT
Z.XHELAL GASHI
